



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna e Kaçanikut

Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	05.06.22	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	01	Shtojcë	104/02-4403/22

Në mbështetje të nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 73 i Statutit të Komunës së Kaçanikut si dhe nenit 9 të Rregullores NR. 04/2017 Mbi Kriteret dhe Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Kryetari i Komunës së Kaçanikut më datë 04.04.2022 merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE

1. Me këtë vendim, formohet komisioni i ankesave në përbërje prej 3 anëtarëve për vlerësimin e ankesave kundër vendimit Nr. 104/02- 4403/22 të Komisionit Vlerësues në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2022 në përbërje prej:
 - Fatmir Çaka- Kryetar i Komisionit
 - Vedat Dema Anëtar
 - Ibush Vishi Anëtar
 - Fadil Guri Anëtar Rezervë
2. Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit vlerësues janë të përcaktuara në nenin 21 të Rregullores NR. 04/2017 Mbi Kriteret dhe Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
4. Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, anëtarët e komisionit dhe arkivi i Komunës.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut

Per z.Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01Nr. 105/02-11011/22
Kaçanik, 21.06.22

Në mbështetje të neneve 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, pas propozimit të drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, kryetari i komunës nxjerr këtë:

VENDIM

Për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit Lokal në Mjedis

- I. Me këtë vendim formohet grupi punues për hartimin e planit të veprimit lokal në mjedis.
- II. Komisioni punues për hartimin e planit të veprimit lokal në mjedis në Komunën e Kaçanikut, do të ketë këtë përbërje:
 1. Qamil Stagova - drejtor i DUKMM - së;
 2. Menduh Krasniqi - shef i sektorit të shërbimeve publike;
 3. Afrim Fuga - zyrtar për menaxhimin e mbeturinave;
 4. Arditë Shehu - zyrtare për mbrojtje të mjedisit;
 5. Eljesa Begunca - zyrtare për hapësira publike;
 6. Ukshin Çallaku - inspektor i shërbimeve publike,
 7. Bujar Dullovi - Inspektor mjedisor;
- III. Komisioni obligohet që menjëherë të filloj punën në hartimin e planit të veprimit lokal në mjedis.
- IV. Komisioni punën e vet, e bën duke patur parasysh nevojat dhe specifikat e komunës së Kaçanikut.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
- VI. Me këtë vendim, njoftohen: Anëtarët e Komisionit dhe Arkivi.

Besim Ilazi

Kryetar i Komunës